



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

**RAPORT**

**PËR VEPRIMTARITË JASHTË FUNKSIONIT, ME PAGESË, TË  
MAGJISTRATËVE PROKURORË PËR VITIN 2019**

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë parashikon se, detyra e prokurorit nuk pajtohet me asnjë veprimtari tjetër shtetërore ose politike, si dhe me veprimtari profesionale që ushtrohet kundrejt pagesës, me përjashtim të aktivitetit mësimdhënës, akademik ose shkencor<sup>1</sup>.

Papajtueshmëria e detyrës së prokurorit me asnjë veprimtari tjetër shtetërore ose politike me përjashtim të veprimtarisë së mësimdhënies, akademike apo shkencore lidhet jo vetëm me parimin e ndarjes së pushteteve por edhe me përgjegjshmërinë për kryerjen sa më mirë të detyrës së prokurorit.

E drejta e magjistratit për të kryer veprimtari jashtë funksionit, të cilat mund të jenë me pagesë ose jo, është rregulluar në nenin 9, të Ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar<sup>2</sup>. Në cdo rast, këto veprimtari duhet të ushtrohen duke respektuar kufijtë ligjorë, duke garantuar dinjitetin e ushtrimit të funksionit, nuk duhet të çënojnë pavarësinë apo të krijojnë perceptime të ndikimit ose njëanshmëri, nuk bien ndesh me interesat thelbësore të funksionit të prokurorit dhe shpërblimi për to nuk duhet të tejkalojë rregullat e zakonshme të tregut. Dispozita në fjalë ka përcaktuar kritere të ndryshme për lejimin e ushtrimit të veprimtarive jashtë funksionit.

Në përputhje me pikën 10, të nenit 9, të këtij ligji, me Vendimin nr. 26, datë 22.02.2019, “Për miratimin e rregullores “Për veprimtaritë jashtë funksionit të prokurorëve”<sup>3</sup>, Këshilli i Lartë i Prokurorisë ka miratuar rregulla të detajuara për zhvillimin e veprimtarive jashtë funksionit të prokurorëve.<sup>4</sup>

<sup>1</sup> Neni 149/ç, i Kushtetutës

<sup>2</sup> Ky ligj është botuar në Fletoren Zyrtare nr. 208, datë 7 nëntor 2016, ka hyrë në fuqi në dt. 23 nëntor 2016

<sup>3</sup> <https://klp.al/2019/05/03/rregullore-per-veprimtarite-jashte-funksionit-te-prokurore-2/>

<sup>4</sup> Botuar në Fletoren Zyrtare nr. 66, datë 8 maj 2019

Kjo rregullore përmban kriteret dhe procedurat që duhet të ndjekin prokurorët dhe Këshilli i Lartë i Prokurorisë, kur shqyrtohen kërkesat e prokurorëve për ushtrimin e këtyre veprimtarive si dhe lejimin e prokurorëve për të ushtruar këto veprimtari nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë.

Sipas ligjit, magjistrati prokuror mund të shkruajë, të publikojë, të japë leksione dhe mësimdhënie për çështjet ligjore dhe të marrë pjesë në veprimtari që lidhen me çështje ligjore, sistemin ligjor, administrimin e drejtësisë dhe çështje të tjera të lidhura me to. Qëllimi i ushtrimit të këtyre veprimtarive është që, prokurorët përveç detyrës së tyre funksionale, të kontribuojnë në zhvillimin e doktrinës, në fushën akademike dhe në përgatitjen e juristëve të rinj.

Para se të fillojë kryerjen e një veprimtarie jashtë funksionit, me pagesë, prokurori duhet të njoftojë Këshillin e Lartë të Prokurorisë dhe të paraqesë dokumentacionin e nevojshëm në të cilin përshkruhet natyra dhe kohëzgjatja e këtyre veprimtarive, vërtetohet masa e shpërblimit të këtyre veprimtarive, evidentohet ngarkesa në punë në prokurori, ngarkesa totale e punës në prokurori, dhe përmbushja në kohë të detyrave përgjatë 12 muajve të mëparshëm.

Prokurori duhet të marrë miratimin e Këshillit të Lartë të Prokurorisë përpara se të pranojë kryerjen e veprimtarive jashtë funksionit, me pagesë. Këshilli vendos dhe jep miratimin nëse veprimtaria jashtë funksionit dhe çdo shpërblim për kryerjen e saj është në përputhje me ligjin.

Brenda muajit janar të çdo viti, Këshillat publikojnë në faqen zyrtare, si dhe i dërgojnë Inspektoratit të Lartë të Deklarimit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave dhe organeve të administratës tatimore një raport me shkrim të arsyetuar për veprimtaritë jashtë funksionit të paguara të magjistratëve, duke përcaktuar pagesën ose shpërblimin e përfituar gjatë vitit paraardhës dhe vlerën përkatëse të tregut.

Që në vitin e parë të veprimtarisë së tij<sup>5</sup>, Këshilli i Lartë i Prokurorisë ka shqyrtuar dhe miratuar disa kërkesa të magjistratëve prokurorë për ushtrimin e veprimtarive të paguara jashtë funksionit.

Në zbatim të dispozitave të mësipërme ligjore, Këshilli i Lartë i Prokurorisë **gjatë vitit 2019** ka miratuar 13 kërkesa<sup>6</sup> për të ushtruar veprimtari të paguara jashtë funksionit, me pagesë. Kërkesat janë paraqitur nga prokurorë të prokurorive të ndryshme si, Prokuroria e Përgjithshme, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krimet e Rënda (sot, Prokuroria e Posacme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar), prokuroritë pranë

---

<sup>5</sup> Këshilli i Lartë i Prokurorisë është krijuar me Vendimin nr. 1, datë 19.12.2018, “Për krijimin e Këshillit të Lartë të Prokurorisë” / <https://klp.al/wp-content/uploads/2019/04/Nr.1-Datë19.12.2018-.pdf>

<sup>6</sup> Informacion i detajuar jepet në Aneksin I “Tabela me informacion lidhur me veprimtaritë jashtë funksionit, me pagesë, të magjistratëve prokurorë, gjatë vitit 2019”, bashkëlidhur këtij Raporti

Gjykatës së Shkallës së Parë Shkodër, Tiranë, Elbasan, Krujë, Prokuroria pranë Gjykatës së Apelit Tiranë dhe prokurorë të komanduar pranë Këshillit të Lartë të Prokurorisë.

Në Aneksin 1, bashkëlidhur këtij Raporti jepet informacion i detajuar që përmban:

- të dhënat e magjistratëve prokurorë që kanë ushtruar veprimtari jashtë funksioni, me pagesë, gjatë vitit 2019;
- institucionin/subjektin ku prokurori ka ushtruar veprimtarinë jashtë funksioni, pozicioni që ka mbajtur dhe lënda ose fusha e veprimtarisë;
- kohëzgjatjen e kontratës/veprimtarisë jashtë funksionit;
- orët e veprimtarisë jashtë funksionit, brenda dhe jashtë orarit të punës, për t'u realizuar;
- masën e pagesës/shpërblimit për t'u përfituar nga kjo veprimtari në kohën e paraqitjes së kërkesës;
- orët e veprimtarisë jashtë funksionit të realizuara në fakt dhe/ose masa e pagesës/shpërblimit e përfituar, nga kjo veprimtari në lekë, etj. (sipas informacionit të sjellë nga vetë magjistratët), dhe;
- vendimin e Këshillit të Lartë të Prokurorisë, për miratimin e veprimtarisë së paguar jashtë funksionit.

Veprimtaritë jashtë funksionit të kryera nga prokurorët i përkasin kryesisht fushave si, e drejtë penale apo procedurë, penale, të ekzekutimit të vendimeve penale, e drejtë penale e posaçme, dënimet alternative ndaj burgimit, lëndët që lidhen me kriminologjinë klinike dhe psikoanalitike, tatimet, doganat dhe veprat penale në fushën e tatimeve dhe doganave, të drejtën familjare, etj.

Institucionet ku prokurorët kanë ushtruar veprimtarinë jashtë funksionit janë institucione të arsimit të lartë publike ose jo publike si dhe organizata të shoqërisë civile si, Shkolla e Magjistraturës, Fakulteti i Drejtësisë pranë Universitetit të Tiranës, Universiteti “Luigj Gurakuqi”, Shkodër, Universiteti “Aleksandër Xhuvani”, Elbasan, Qendra e Trajnimit të Administratës Tatimore dhe Doganore, Universiteti “New York”, Tiranë, Universiteti Evropian i Tiranës, Kolegji Universitar “Bedër”, Tiranë, Kolegji Universitar “Qiriazi”, Tiranë dhe OJF-ve si, Qendra Për Iniciativa Ligjore, Instituti për Kontratën Shoqërore, etj.

Magjistratët prokurorë kanë ushtruar këto veprimtari në cilësinë si udhëheqës shkencor, pedagogë ose lektorë të jashtëm për leksione dhe seminare, ekspertë, trajnerë, etj., pranë institucioneve të mësipërme. Periudha e ushtrimit të këtyre veprimtarive është e shtrirë në vitet akademike 2018-2019 dhe 2019-2020.

Në funksion të përgatitjes së këtij raporti, Këshilli i Lartë i Prokurorisë ka kërkuar informacion zyrtarisht<sup>7</sup> nga magjistratët prokurorë për të cilët është miratuar veprimtaria jashtë funksionit, me pagesë, për vitin 2019, për çështje si:

<sup>7</sup> Me Shkresën nr. 1398, datë 15.09.2020, Shkresën nr. 1389, datë 15.09.2020, Shkresën nr. 1388, datë 15.09.2020, Shkresën nr. 1393, datë 15.09.2020, Shkresën nr. 1394, datë 15.09.2020, Shkresën nr. 1444, datë 25.09.2020, Shkresën nr. 1395, datë 15.09.2020, Shkresën nr. 1396, datë 15.09.2020, Shkresën nr. 1397, datë 15.09.2020,

- i. prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së I-rë ku kanë ushtruar detyrën gjatë kryerjes së veprimtarisë së paguar jashtë funksionit;
- ii. institucioni, organizata, etj., ku kanë ushtruar veprimtarinë e paguar jashtë funksionit si dhe pozicionin që kanë mbajtur në veprimtari;
- iii. kohëzgjatja e kontratës/veprimtarisë së paguar jashtë funksionit, dhe;
- iv. orët e veprimtarisë së paguar jashtë funksionit si dhe masa e pagesës/shpërblimit, e përfituar gjatë vitit 2019 (në lekë, etj).

Bazuar në sa më sipër si dhe në informacionin e dërguar nga magjistratët që kanë ushtruar veprimtari jashtë funksioni, me pagesë, është përgatitur ky Raport dhe Aneksi 1, bashkëlidhur.

Gjithashtu, ka rezultuar se, gjatë vitit 2019, këta magjistratë ka përfituar pagesë për veprimtari mësimdhënie të ushtruara para këtij viti (si pagesa të prapambetura, etj) apo sipas lejes përkatëse, të miratuar nga Prokurori i Përgjithshëm<sup>8</sup>.

---

Shkresën nr. 1399, datë 15.09.2020, Shkresën nr. 1392, datë 15.09.2020, Shkresën nr. 1391, datë 15.09.2020 dhe Shkresën nr. 1390, datë 15.09.2020

<sup>8</sup> Përpara krijimit të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, sipas ligjit